

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

1. MATERIALE KËRKIMORE	2
2. AKTIVITETE KËRKIMORE	6
3. LINGJE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	9

Numri 27 i materialit "Të Rejat shkencore në Bankën e Shqipërisë" pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2021.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1. MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike me fokus tema mbi monedhat digjitale, politikën monetare, stabilitetin financiar, zhvillimet demografike, familjet dhe kulturën financiare etj. Në mënyrë të përmbledhur ato paraqiten më poshtë:

"Ndikimi i monedhave digjitale në ciklin dhe stabilitetin financiar" nga Natasha Ahmetaj (Zëvendësguvernator i Dytë), Bledar Hoda (Departamenti i Kërkimeve), Livia Nikolla dhe Arisa Saqe (Departamenti i Stabilitetit Financiare)

Në këtë punim, autorët krahasojnë monedhat digjitale të tre kategorive të ndryshme, kriptomonedhat digjitale me çmim të luhatshëm, kriptomonedhat me çmim fiks si stablecoin dhe paranë elektronike të bankave qendrore (PEBQ) në tregun e monedhave

digjitale. Krahasimi i tyre është bërë në bazë të kriterëve relative bazike si: (i) lehtësia e kryerjes së transaksioneve, (ii) luhatshmëria e çmimit, (iii) mundësia e dështimit të tyre, dhe (iv) lehtësia e aksesit të secilës forme të parasë për të gjetur atë me përhapje të gjerë në publik. Mes dy alternativave private, stablecoin kanë një perspektivë për të gjetur përdorim më të gjerë në publik. Megjithatë, bazuar në rishikimin e literaturës, rezultojnë se stablecoin mbart rreziqe të ngjashme me ato të një tregu financiar tradicional të parregulluar dhe një sfidë për autoritetet kombëtare. Në veçanti, nënvizohet se përhapja e një ekosistemi të stablecoin mund të sfidojë ndërmjetësimin bankar e financiar në tregjet tradicionale financiare, të rritë mundësinë e panikut bankar dhe fenomenit të tërheqjes së menjëhershme të fondeve nga bankat, si dhe të përshkallëzojë transmetimin e goditjeve dhe cikleve financiare midis ekonomive të ndryshme. Rreziqet që vijnë nga përdorimi më i gjerë i produkteve dhe shërbimeve FinTek (teknologjisë financiare)

janë gjithashtu një burim paqëndrueshmërie për sistemin financiar, sidomos kur aktorët financiarë ekspozojnë bilancet e tyre ndaj këtyre produkteve.

“A luan rol paraja në mekanizmin e transmetimit monetar në Shqipëri?” nga Altin Tanku dhe Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve

Për shkak të rrethanave ekonomike e financiare në dekadën e fundit, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare akomoduese duke ulur normën bazë nga mbi 5% që ishte në fillim të vitit 2010 në gati 1% në mesin e vitit 2016. Politika monetare ka operuar që atëherë në nivelet më të ulëta historike e shqetësuar nga norma e inflacionit poshtë objektivit të saj, edhe pse aktiviteti ekonomik është rritur në vetëm pak më poshtë se niveli potencial i tij. Ruajtja e normës bazë në nivele shumë të ulëta për një numër vitesh dhe mosarritja për të kthyer inflacionin në shënjestër ka ngjallur shqetësime për eficiencën e veprimeve të politikës monetare nëpërmjet kuadrit të vendosjes së normës së interesit. Për më tepër, nisur dhe nga përpjekjet e periudhës së fundit për të përballuar goditjet dhe pasiguritë e shkaktuara nga masat për kontrollimin e efekteve të pandemisë COVID-19, interesimi për rivlerësimin e efektshmërisë së instrumenteve të politikës monetare në mekanizmin e transmetimit është rritur shumë. Ky studim përpjetet të masë vlefshmërinë empirike të rëndësisë së parasë si një tregues informativ duke përdorur një model të vogël me vektorë autoregresivë. Rezultatet tona paraprake vënë në pikëpyetje këndvështrimin aktual se qëndrimi i politikës monetare mund të përshkruhet me referencë ekskluzive të goditjeve të normës së interesit dhe pa konsideruar ecurinë e agregatëve monetarë. Përdorimi në veçanti i parasë

së gjerë dhe dallimi i goditjeve të kërkesës për para nga oferta e parasë është gjetur se ndihmojnë në përmirësimin e analizës vektoriale dhe në mënjanimin e konfuzioneve në lidhje me likuiditetin dhe kursin e këmbimit. Treguesit monetarë mund të shërbejnë si tregues informativ për çmimet dhe kursin e këmbimit, megjithëse jo dhe aq për aktivitetin ekonomik, të përafëruar me produktin e brendshëm bruto.

“Kërkesa dhe oferta në tregun e huasë bankare: A ka përjetuar Shqipëria një episod të krizës (çekuilibër) pas krizës financiare globale?”, nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve

Ky punim paraqet një analizë empirike të hipotezës të ekzistencës së një episodi të mundshëm krize (racionimi) në tregun e kredisë në Shqipëri duke u përqendruar veçanërisht në periudhën pas krizës financiare globale. Duke përdorur të dhëna makroekonomike dhe ato nga sektori bankar, veçohet kërkesa dhe oferta e kredisë duke vlerësuar një model dinamik çekuilibri të tregut shqiptar të huasë bankare sipas qasjes standarde VAR. Analiza përfshin tregun e huasë bankare ndaj firmave dhe individëve, duke i kryqëzuar me të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues. Rezultatet kryesore nuk mbështesin një çekuilibër relativisht të fortë të tregut të kredisë në Shqipëri, i cili do të lidhej veçanërisht me episodet e krizës së kredisë. Megjithatë, rezultatet japin dëshmi që mbështesin hipotezën e racionimit të kredisë në rastet e firmave dhe individëve. Episode të tilla zbulohen se ndodhin si në kahun e kërkesës, ashtu dhe në atë të ofertës. Në mënyrë të ngjashme, këto episode janë gjetur të zgjasin më tepër në rastin e firmave. Në të njëjtën kohë, edhe madhësia e racionimit të kredisë është më e madhe në rastin e firmave.

“Vlerësimi i Ndikimit të Kushteve Makroekonomike Globale në Flukset Kapitale në Shqipëri” nga Bledar Hoda, Departamenti i Kërkimeve

Flukset financiare dhe kapitale të bilancit të pagesave (BP) janë kritike për ekonominë e vogla dhe në zhvillim. Qëndrueshmëria e këtyre flukseve kontribuon në rritjen ekonomike, zbutjen e luhatjeve të konsumit dhe diversifikimin e rrezikut nga luhatja e të ardhurave. Gjithashtu, luhatjet e tyre janë të lidhura ngushtë me dinamikën makroekonomike të një ekonomie. Nisur nga kjo rëndësi e tyre, materiali analizon ndikimin e kushteve makroekonomike globale në flukset financiare neto dhe bruto të bilancit të pagesave. Gjetjet që dalin nga ky studim nënvizojnë ndikimin e fortë të indeksit të pasigurisë VIX në tregjet globale financiare, shpesh i identifikuar si tregues i ciklit global financiar, si një përcaktues kryesor të flukseve neto dhe bruto të BP. Gjithashtu, tregues të Eurozonës si indeksi i bursës Evropiane (Dow Jones Eurostoxx 50) dhe kërkesa agregate rezultojnë të rëndësishëm për sjelljen e flukseve bruto të investimeve direkte dhe të flukseve kapitale të orientuara në pjesëmarrje aksionare. Nisur nga pesha e lartë e flukseve kapitale dhe financiare të BP në ekonominë shqiptare prej rreth 10-14% të PBB-së, rezultatet e mësipërme janë në linjë me gjetje të studimeve të mëhershme se faktorët globale dhe të Eurozonës janë të rëndësishëm për ciklin e biznesit dhe atë financiar në Shqipëri.

“Vlerësimi i efekteve të ndryshimeve demografike në ekonominë shqiptare”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Ndryshimet demografike mund të kenë implikime të rëndësishme për politikën monetare, veçanërisht kur normat nominale të interesit janë në kufirin e poshtëm

zero. Ky punim analizon reagimin e treguesve makroekonomikë ndaj goditjeve demografike bazuar në modelin e Gertler, me tregues demografikë të ndryshueshëm në kohë dhe rritje konstante të produktivitetit, si dhe tregues fiskalë. Modeli është përdorur për të vlerësuar një sërë skenarësh për ekonominë shqiptare për 20 dhe 100 vitet e ardhshme, duke përdorur projeksionet e OKB-së për tregues të caktuar demografikë. Punimi gjen se ndryshimet demografike kanë kontribuar me kalimin e kohës në një rënie të normës ekuilibër të interesit dhe efektet e tyre supozohet të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme, gjë që mund të kërkojë reagim të politikës monetare për të zbutur efektet e tyre negative në tregues të caktuar ekonomikë.

1.2. MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

“Qëndrueshmëria financiare e shqiptarëve: A ka rëndësi edukimi financiar?” nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve

Kriza financiare globale dhe kriza pandemike e COVID-19 nxorën në pah rëndësinë që ka mirëqenia financiare e familjeve në përballimin e goditjeve të tilla si: rënia e papritur e të ardhurave, humbja e vendit të punës ose shpenzime të papritura. Qëllimi i këtij materiali është të eksplorojë qëndrueshmërinë financiare të shqiptarëve bazuar në të dhënat e Vrojtimit mbi Kulturën Financiare të të rriturve në Shqipëri, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2019. Për më tepër synohet të vlerësohet rëndësia e kulturës financiare të individit në qëndrueshmërinë financiare të tij.

“Ecuria e performancës së sistemit bankar shqiptar mbas krizës financiare globale”, nga Fiqiri Baholli, Departamenti i Kërkimeve

Sistemi bankar në Shqipëri përbën peshën kryesore të sistemit financiar, duke luajtur

një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin financiar në vend. Si rrjedhojë, analizimi i performancës së tij, kryesisht mbas krizës financiare globale paraqet interes për të identifikuar zërat që kanë kontribuar më shumë në të. Analizimi i performancës për të gjithë sistemin bankar në harkun kohor 2010 – 2020 është bërë mbi modelin e përshtatur të Dupont nga David Cole (1972) duke parë ndërlidhjet midis mesatares së kthimit nga kapitali (ROE) dhe mesatares së kthimit nga aktivet (ROA), si dhe komponentëve të tjerë. Punimi përdor kryesisht metodat krahasuese dhe eksploruese, sugjeruar nga literatura, si dhe të dhënat statistikore të Bankës së Shqipërisë.

1.3. ARTIKUJ KËRKIMORË

“Kanali i kredisë dhe transmetimi monetar në vendet e Evropës Qendrore, Lindore e Juglindore”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Ky artikull shqyrton funksionimin e kanalit të kredisë bankare të transmetimit të politikës monetare në dhjetë vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQLJL) përgjatë periudhës 2010-2018. Duke përdorur të dhënat e bankave individuale marrë nga baza e të dhënave Bankscope, artikulli synon të studiojë: (i) nëse kushtet monetare ndikojnë në kreditimin e bankave në vende të caktuara të EQLJL; (ii) nëse ekziston ndonjë lidhje lineare midis karakteristikave të caktuara bankare (madhësia dhe kapitalizimi) dhe normës së rritjes së kredisë; dhe (iii) efektivitetin e kanalit të kredisë bankare, duke parë nëse ka efekte shpërndarëse në ndikimin e politikës monetare në kredidhënien bankare, për shkak të karakteristikave individuale bankare.

“Brishtësia e familjeve shqiptare dhe Covid-19”, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve

Qëllimi i këtij artikulli është eksplorimi i brishtësisë financiare së familjeve shqiptare, si dhe vlerësimi i nivelit të të ardhurave dhe konsumit të familjeve, ndikuar nga masat e marra mbi mbylljen totale të ekonomisë në periudhën mars-prill 2020, për mos përhapjen e COVID-19. Brishtësia e familjeve shqiptare dhe vlerësimet mbi të janë bazuar në të dhëna të detajuara të familjeve marrë nga vala e parë e Vrojtimit mbi Pasurinë e Familjeve Shqiptare, zhvilluar nga Banka e Shqipërisë, në 2019. Skenarët që rezultojnë nga efektet e përkohshme dhe të para të shkaktuara nga mbyllja e plotë e ekonomisë në mars-prill 2020, si rezultat i COVID-19 tregojnë për një rënie të të ardhurave totale të familjeve me 13%-16% dhe të konsumit agregat të familjeve me 9-11 %, që është i ndryshëm për grupe të ndryshme të familjeve. Gjithashtu, ulja e të ardhurave agregate pritet të shoqërohet edhe me rritje të numrit të familjeve të varfra.

“Evidenca mbi kulturën dhe përfshirjen financiare në Shqipëri” nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Artikulli paraqet evidenca mbi kulturën dhe përfshirjen financiare në Shqipëri bazuar në të dhënat e Vrojtimit për Matjen e Kulturës Financiare të Popullatës të zhvilluar nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2019. Individët në Shqipëri zotërojnë vetëm 53% të totalit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve të duhura financiare, e cila reflektohet edhe në një nivel të ulët të përfshirjes financiare. Vetëm 54% e individëve në Shqipëri njohin të paktën pesë produkte financiare, përkundrajt 83% të individëve në nivel global. Rezulton se

individët në Shqipëri përdorin më shumë mjetet e pagesës, por niveli i përdorimit të tyre është pothuajse 2.5 herë më i ulët se niveli global i përdorimit të tyre. Evidentohet se gratë, të rinjtë, të moshuarit, individët pa edukim minimal etj. janë grupet me nivel më të ulët të kulturës financiare, të cilat duhet të përfshihen më së shumti në programet e edukimit financiar, për të pasur në të ardhmen një rritje të kulturës dhe mirëqenies financiare të gjithë shoqërisë.

“Dinamikat e ndryshueshme të shpërndarjes së kushtëzuar të inflacionit”, nga Lorena Skufi, Departamenti i Politikës Monetare, Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve

Diskutimi i rreziqeve të inflacionit, nëse ato janë të balancuara apo të anuara nga lart ose poshtë, zë një vëmendje të rëndësishme në vlerësimet dhe mënyrën e komunikimit nga ana e bankës qendrore. Kjo pasi rreziqet e inflacionit, mund të ndikojnë potencialisht në pritjet e agjentëve privatë dhe si rrjedhim, edhe në vendimet e tyre. Në këtë këndvështrim, ky artikull synon të studiojë rreziqet e inflacionit, duke u përpjekur të vlerësojë gjithashtu asimetritë në ndikimin e faktorëve makroekonomikë të “kurbës së Phillips-it” përgjatë intervaleve të ndryshme të shpërndarjes së inflacionit në Shqipëri.

1.4. ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE

“Efektet makroekonomike të COVID-19: një rishikim afatmesëm” nga Phurichai Rungcharoenkitkul, Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS)

Ky artikull ofron një vlerësim të pasojave të përkohshme makroekonomike shkaktuar nga COVID-19. Vlerësimet sugjerojnë një humbje mesatare të prodhimit prej rreth 6.5% në vitin 2020, një hendek që

pritet të ngushtohet në rreth 4% (nivel para pandemisë), deri në fund të vitit 2021. Megjithatë, ka vlerësime të ndryshme të humbjeve ekonomike në të gjithë ekonominë, duke reflektuar diferencat në ekspozimet ndaj pandemisë dhe reagimeve të shoqërive. Treguesit me frekuencë të lartë dhe modelet epidemiologjike ofrojnë disa mënyra mbi ndërveprimet midis evolucionit të pandemisë dhe strategjive të shoqërive për ta luftuar atë, duke përfshirë rolin e vaksinimit. Artikulli nxjerr mësim nga përvojat e deritanishme dhe diskuton sfidat për të ardhmen.

<https://www.bis.org/publ/work959.htm>

“Çfarë e nxit çmimin e arit?” nga Robert Barsky, Craig Epstein, Adrian Lafont-Mueller, Younggeun Yoo, Banka e Rezervës Federale së Çikagos (Federal Reserve Bank of Chicago)

Një gjysmë shekulli pasi ari pushoi së luajturi një rol formal të rëndësishëm në sistemin monetar ndërkombëtar, ai ende tërheq një vëmendje të madhe në shtypin financiar dhe imagjinatën popullore. Megjithatë, ka pasur shumë pak shqyrtim të faktorëve kryesorë që përcaktojnë çmimin e arit që kur çmimi i tij në dollarë u lejua për herë të parë të ndryshonte lirisht në vitin 1971. Në këtë artikull, autorët përpiqen ta plotësojnë këtë boshllëk duke marrë në konsideratë, tre nxitësit kryesorë të çmimit të arit: pritjet inflacioniste, normat reale të interesit dhe pesimizmi për të ardhmen makroekonomike.

<https://www.chicagofed.org/publications/chicago-fed-letter/2021/464>

“Duke humbur tërheqjen? Efektet reale të politikës monetare kur normat e interesit janë të ulëta”, nga Rashad Ahmed, Claudio Borio, Piti Disyatat, Boris Hofmann, Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS)

A ka kufizime se sa mund të rrisin kërkesën

agregate reduktimet në normat e interesit? Në veçanti, me rënien e normave të interesit në nivele shumë të ulëta, a zbehet efektiviteti i politikës monetare në nxitjen e ekonomisë? Bazuar në një panel prej 18 vendeve të zhvilluara duke filluar nga viti 1985, autorët konfirmojnë se transmetimi monetar në aktivitetin ekonomik është dukshëm më i dobët kur normat e interesit janë të ulëta. Rezultatet mbeten të pandryshuara edhe kur vlerësohet për sjelljen jolineare midis nivelit të borxhit dhe ciklit të biznesit, si dhe për tendencën rënëse të normave ekuilibër të interesit. Gjithashtu autorët gjejnë se efektiviteti i politikës monetare zvogëlohet për aq kohë sa normat e interesit qëndrojnë të ulëta. Këto gjetje sugjerojnë se rrafshimi i vëzhguar i kurbës së Filipsit ka shkuar paralelisht me një pjerrësi korresponduese të kurbës IS, duke treguar që ndërveprimet e politikës monetare të jenë bërë më sfiduese.

<https://www.bis.org/publ/work983.htm>

“Kursimet, efikasiteti dhe natyra bankrun” nga Agnese Leonello, Caterina Mendicino, Ettore Panetti, Davide Porcellacchia, Banka Qendrore Evropiane (ECB)

A është i lartë niveli i ndërmjetësimit financiar? A ka rëndësi niveli i depozitave për stabilitetin dhe efikasitetin? Nëse po, a i përveçtojnë saktë depozituesit këto efekte kur vendosin se sa të kursejnë? Në dritën e rritjes dramatike të depozitave bankare si në SHBA ashtu edhe në eurozonë me fillimin e krizës së COVID-19, përgjigjja e këtyre pyetjeve është me rëndësi parësore. Ky punim studion nivelin e depozitave si një burim të brishtësisë së bankave dhe implikimet e tij për eficiencën përmes një modeli standard të drejtuar nga banka, i shtuar me një vendim për kursimin e konsumit. Autorët tregojnë se niveli i depozitave ka rëndësi për brishtësinë e bankës dhe nxjerr në pah ekzistencën e një eksternaliteti kursimi që çon në brishtësi tepër të lartë bankare dhe në ofrimin e likuiditetit në mënyrë joefikase.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/>

2. AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 TAKIMI I 15-TË RAJONAL KËRKIMOR NË EVROPËN JUGLINDORE

Në datat 6-7 dhjetor 2021, Departamenti i Kërkimeve i Bankës së Shqipërisë organizoi takimin e 15-të të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore, me qëllim mbështetjen dhe promovimin e kërkimit ekonomik, si dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, por dhe më gjerë në fushat e bankingut qendror, të paraqitura si vijon:

- Monedhat digjitale të bankave qendrore, rreziqet dhe mundësitë e revolucionit financiar;

- Shqetësimet mjedisore, modelimi dhe zhvillimet makrofinancuese;
- Covid-19, efektet afatshkurtra dhe afatgjata, sfidat dhe politikat e bankave qendrore;
- Big-data, machine learning dhe inteligjenca artificiale për politikat e bankave qendrore;
- Evoluimi i stabilitetit monetar dhe financiar si mjete të dobishme për në kohë goditjesh;
- Edukimi dhe rreziku financiar, implikimet për institucionet dhe mbikëqyrësit;
- Dobësitë financiare dhe rezistenca e familjeve gjatë dhe pas krizës pandemike.

Edhe këtë vit, ky aktivitet u organizua online në kushtet e distancimit social si pasojë e pandemisë COVID-19. Lista e temave të prezantuara në këtë aktivitet është si më poshtë:

- "Rreziku global dhe dollari", nga Georgios Georgiadis, Gernot J. Müller, Ben Schumann (Banka Qendrore Evropiane; Universiteti i Tübingen dhe CEPR; Universiteti i Lirë i Berlinit);
- "Funksioni i reagimit të politikës monetare jolineare dhe bazat makroekonomike në Indi", nga Vishal Sharma, Sana Fatima, Masudul Hasan Adil, (Instituti i Menaxhimit të Biznesit, Universiteti GLA, Mathura, Indi; Universiteti Aligarh Muslim, Indi; Instituti Indian i Teknologjisë, Palakkad, Indi);
- "Vlerësimi i cikleve të biznesit dhe financiar në Slloveni", nga Črt Lenarčič (Banka e Sllovenisë);
- "Vlerësimi i ndikimit të kushteve makroekonomike globale në flukset e kapitalit në Shqipëri", nga Bledar Hoda (Banka e Shqipërisë);
- "Nowcasting inflation food me një sasi masive çmimesh online", Pawel Macias, Damian Stelmasiak, Karol Szafranek (Narodowy Bank Polski);
- "Parashikimi i aktivitetit real ekonomik duke përdorur indeksin e stresit financiar: dëshmi nga vendet e zhvilluara dhe në zhvillim", nga Shenglin Ben, Man Luo, Andreas Tsopanakis (Universiteti Zhejiang, Kinë; Universiteti Cardiff, MB);
- "Menaxhimi i ndryshimeve në shërbimet dhe performancën bankare duke përshtatur teknologjinë financiare (Fintech): Një rast i sistemit bankar të Maqedonisë", nga Artina Bedjeti Baftijari, Leonid Nakov (Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi, Shkup, Maqedonia e Veriut);
- "Shqyrtimi i tregtisë së shërbimeve dhe roli i saj potencial për zhvillim ekonomik", nga Jasna Tonovska, Misho Nikolov (Fakulteti Ekonomik në Shkup, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- "Diferencat e riskut midis kredive të korporatave jeshile dhe atyre jo të gjelbra. Dëshmi nga sistemi bankar rumun", nga Florin Dragu, Florian Neagu, Amalia Stamate, Luminita Tatarici (Banka Kombëtare e Rumanisë);
- "Ndryshimet demografike dhe implikimet e tyre në ekonominë shqiptare", nga Meri Papavangjeli (Banka e Shqipërisë);
- "Roli i komunikimit të bankës qendrore në ekonominë në zhvillim të Evropës Lindore që synojnë inflacionin" Nga Alessio Ciarlone (Banka d'Italia);
- "A ka rëndësi edukimi financiar? Rasti Shqiptar", nga Elona Dushku (Banka e Shqipërisë);
- "Karrotë dhe shkop. Efektet në PBB të mbështetjes ekonomike dhe politikave të rrepta në përgjigje të COVID-19", nga Vincenzo Alfano, Salvatore Ercolano, Mauro Pinto (Universiteti Ndërkombëtar Westminster në Tashkent & Qendra për Studime Ekonomike CES-ifo; Universiteti i Basilicata; Universiteti i Campania Luigi Vanvitelli);
- "Ndërveprimi i goditjeve të ofertës dhe kërkesës: Matja e prodhimit të mundshëm në pandeminë COVID-19", nga Lovorka Grgurić, Ozana Nadoveza Jelić, Nina Pavić, Hrvatska Narodna Banka (Banka Kombëtare Kroate);
- "A do të lërë plagë të qëndrueshme pandemia COVID-19 në ndjenjat ekonomike të individëve të EQIJ-së?", nga Melanie Koch, Thomas Scheiber

- (Oesterreichische Nationalbank, Austri);
- "A ka rol paraqja në matjen e politikës monetare në Shqipëri", nga Altin Tanku, Ilir Vika (Banka e Shqipërisë).

2.2 ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2020

Banka e Shqipërisë, në kuadër të inkurajimit të studentëve të ekonomisë si brenda dhe jashtë vendit, për tu angazhuar në punë cilësore kërkimore shkencore në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe financës, organizoi edhe gjatë vitit 2021, konkursin e hapur të "Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të mirë". Në këtë konkurs morën pjesë studentë si nga universitetet brenda dhe jashtë vendit, me tematika të lidhura me ekonomiksin monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar etj. Më poshtë gjeni një përmbledhje të tre temave fituese.

Me çmim të parë u vlerësua zj.Ervi KOSTA, studente e Masterit të Shkencave në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës, me temën: "Diversifikimi i të ardhurave dhe ndikimi i tij në performancën financiare të bankave tregtare", një aspekt thelbësor i mirëfunksionimit të sistemit bankar shqiptar. E veçanta e punës kërkimore të këtij materiali është shqyrtimi nëpërmjet vlerësimeve me regrese të tipit panel i lidhjes midis performancës financiare të bankave

të nivelit të dytë dhe nivelit të diversifikimit të të ardhurave të tyre. Nga kjo analizë kuptojmë se mbetet ende mjaft punë për t'u bërë nga bankat e nivelit të dytë, përse i përket përfitueshmërisë së sistemit nëpërmjet diversifikimit të të ardhurave.

Çmimi i dytë shkon për zj. Marina POPPA, studente e ciklit Master në Ekonomi Zhvillimi, City University, Londër, me temë: "Vlerësimi i rolit të mjedisit makroekonomik dhe institucional në performancën e institucioneve mikro-financiare në Shqipëri". Ky material analizon aktivitetin e institucioneve mikro-financiare në Shqipëri, një aktivitet kyç për nxitjen e përfshirjes në kredimarrje për segmentet e popullsisë më pak të angazhuara në ekonomi, siç janë rezidentët me të ardhura të ulëta dhe ata të përqendruar në zonat rurale. Masa e përfshirjes financiare të popullsisë është tregues i drejtpërdrejtë i nivelit të sipërmarrjes ekonomike, dhe institucionet mikro-financiare luajnë një rol vendimtar në stimulimin e kësaj përfshirjeje.

Me çmim të tretë vlerësohet zj.Kristjana PROKO, studente e Masterit të Shkencave në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës me temën: "Tatimi optimal për të ardhurat nga paga – rasti i Shqipërisë". Ky material trajton një temë me rëndësi dhe që vazhdon të jetë pjesë e diskutimeve midis ekonomistëve për nivelin optimal të taksimit të të ardhurave nga paga.

3.LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:**Banca d'Italia**

<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

<http://www.cnb.cz/en/research/>

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

http://www.ecb.int/home/html/researcher_en.html

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp

